



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Nr. 3838 Prot.

Tiranë më, 11 . 02 . 2016

Lenda: Urdhër për garantimin e detyrimit të akcizës së pullave të akcizës.

Me qëllim marrjen e masave për zbatimin me korrektësi të legjislacionit doganor në fushën e Akcizës lidhur me garantimin e detyrimeve të akcizës;

Me qëllim marrjen e masave për zbatimin me korrektësi të legjislacionit doganor në fushën e Akcizës lidhur me garantimin e detyrimeve të akcizës;


Bazuar në nenet 24-29 dhe pikën 3 të nenit 40 të Ligjit 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM 612/2012 ‘Për dispozitat zbatuese të ligjittë akcizës’ i ndryshuar, Udhëzimin nr. 19, datë 01.09.2011 ‘Për modalitetet e aplikimit të pullave të akcizës dhe pullave fiskale në produktet e duhanit, birrës dhe alkoolit’ i ndryshuar si dhe në nenin 3 pika 2 gërma “a” e VKM 205 datë 13.4.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor” të ndryshuar”:

Urdhëroj:

1. Miratimi i porosisë së pullave të akcizës, kushtëzohet nga depozitimi i garancisë bankare konform pikës 3 të nenit 40 të Ligjit 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.
2. Garancia bankare do të jetë e llojit sipas përcaktimit të nenit 24 të ligjit 61/2012 “për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
3. Garancia bankare duhet të jetë në shumën që bën të mundur garantimin 100% të detyrimeve të akcizës që i përket sasisë totale të pullave që ndodhen jashtë territorit doganor shqiptar në çdo kohë.
4. Për subjektet e autorizuar si depozitues të miratuar stokues, garancia bankare do të llogaritet për të mbuluar 100% të detyrimit të akcizës për gjendjen e mallit stok në magazinë fiskale, dhe të detyrimeve të akcizës që i përgjigjet sasisë së pullave fiskale të porositura për tu dërguar jashtë teritorit doganor shqiptar.
5. Për subjektet e autorizuar me magazinë doganore, dhe që janë importues të produkteve të akcizës, garancia bankare do të llogaritet për të mbuluar 100% të detyrimit të akcizës për gjendjen e mallit stok në magazinë doganore dhe të detyrimeve të akcizës që i përgjigjet sasisë së pullave fiskale të porositura për tu dërguar jashtë teritorit doganor shqiptar.

6. Për subjektet importues të produkteve të akcizës me detyrim pajisjen me pulla fiskale, që nuk janë të autorizuar si depozitues të Miratuar apo Magazina Doganore, formati i certifikatës së garancisë bankare, duhet të përmbajë të paktën të dhëna sipas përcaktimeve të nenit 76 pika 1, e VKM nr. 612, datë 5.9.2012, "Për dispozitat zbatuese të ligjit "Për akcizat" i ndryshuar (një model të këtij formati do ta gjeni bashkëlidhur këtij urdhëri).
7. Struktura përgjegjëse pranë Departamentit të Akcizës, për çdo porosi të pullave fiskale, duhet të kontrollojë përmbushjen e kushteve të mbulimit me garanci bankare të detyrimeve të akcizës që i përgjigjet sasisë së pullave fiskale të porositura.
8. Në rastet e mos përmbushjes së kërkesave të garantimit, subjekteve aplikuese i refuzohet porosia.
9. Për sasinë e pullave të akcizës, të cilat në datën e hyrjes në fuqi të këtij urdhëri gjenden jashtë territorit doganor shqiptar dhe për të cilat nuk janë garantuar detyrimet e akcizës në momentin e porositjes, sipas pikës 3 te nenit 40, Sektori i Lehtësirave Fiskale, në Drejtorinë Teknike të Departamentit të Akcizës, njofton nominativisht operatorët që trajtojnë mallra akcize, që të depozitojnë certifikatën e garancisë bankare në fjalë, jo më vonë se 5 ditë pune nga marrja e njoftimit. Në këto raste, nuk do të miratohen porosi për sasi të tjera pullash, pa u rregulluar më parë situata e garantimit të detyrimeve të akcizës, për sasinë e pullave gjendje jashtë territorit doganor shqiptar.
10. Në rastet e evidentimit të sasive të pullave fiskale të dërguar jashtë territorit doganor shqiptar, për të cilat nuk është depozituar garancia bankare edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 9 të këtij Urdhëri, merren masat për evidentimin e detyrimit të munguar të akcizës dhe procedimin sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar".
11. Zbatimi i procedurave të përcaktuara në pikat 9 dhe 10 të këtij urdhëri, çliron subjektet nga detyrimi për riimportimin e sasisë së pullave të papërdorura gjendje jashtë territorit doganor shqiptar, sipas shkresës nr.2868 Prot., datë 02.02.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
12. Çertifikata e garancisë bankare, duhet të rinovohet jo më pak se 5 ditë përpara mbarimit të afatit të certifikatës ekzistuese. Në rast të mos rinovimit të garancisë brenda këtij afati, autoritetit doganor paraqet kërkesën për kalimin e shumës në llogarinë e Drejtorisë së përgjithshme të Doganave.
13. Ngarkohet struktura përgjegjëse pranë Departamentit të Akcizës me zbatimin e këtij Urdhëri.
14. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PRANVERA FAGU (BEHUSHI)
DREJTJOR I PERGJITHSHEM



ANEKSI 1

Nr. _____ Prot.

xxxx më dd.mm.yyyy

GARANCI

Garantuesi: _____ (Institucioni Garantues) _____.

I Garantuari: (shoqëria/Nipt _____.

Përfituesi : Drejtorina e Përgjithshme të Doganave.

Shoqëria “ _____ ” me NIPT _____, kryen aktivitetin e Importimit të produkteve të akcizës (_____ lloji i produktit _____);

Në përmbushje të detyrimeve të nenit 40 pika 3 e Ligjit 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku kërkohet që vlera e detyrimit të akcizës, të garantohet në momentin e blerjes së pullave, depozitojmë këtë garanci në shumën xxxxxxxxxxxx Lekë (shuma në fjalë);

Me këtë dokument vërtetojmë se ne, (emri i institucionit garantues), marrim përsipër t’i paguajmë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, çdo shumë brenda shumës totale prej xxxxxxxxxxxx Lekë (shuma në fjalë _____), shumë e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar më sipër . Kalimi i shumës në llogarinë e përfituesit (Drejtoria e Përgjithshme të Doganave), do të bëhet sapo të paraqitet kërkesa e parë me shkrim dhe pa qenë nevoja të bëni argumentimin e kërkesës.

Me këtë garanci, ju sigurojmë se nuk është e nevojshme t’i drejtoheni më parë Shoqërisë “ (emri i subjektit/ Nipti)” për të realizuar pagesën në lidhje me këtë garanci.

Kjo garanci është e vlefshme deri me ardhjen e urdhërit të çbllokimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por jo më vonë se data dd.mm.yyyy (afat 1 vjeçar).

Kjo garanci (brenda afatit të mësipërm) do të çbllokohet me kthimin e origjinalit të *Garancise* ose me paraqitjen e kërkesës së parë me shkrim për ç’ngurtësim nga Përfituesi i kësaj Garancie.

Me mbarimin e këtij afati, kjo garanci bëhet e pavlefshme dhe (Institucioni garantues) është i çliruar nga çdo lloj detyrimi ndaj Jush , në lidhje me këtë garanci.

Për qëllim autentifikimi, ju lutemi kontaktoni në numrat e telefonit : _____ (tel i institucionit lëshues) _____ dhe në e-mailin: _____ emaili i institucionit _____ lëshues).

Nënshkrimet e përfaqësuesve të institucionit autorizues